

VENDIM
Nr.14, datë 5.3.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRCAKTIMIT TË ÇMIMIT UNIK TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA HEC-ET E RINJ, ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË
10 MW, TË DHËNË ME KONCESION, PËR VITIN 2007**

Në mbështetje të neneve 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve” kreu IV pika 1 “a” të këtyre rregullave, nenit 11 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.5.2004, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 5.3.2007, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhënë me koncesion, për vitin 2007,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit unik të energjisë elektrike, të prodhuar nga HEC-et e rinj, me fuqi të instaluar deri në 10 MW, të dhënë në koncesion për vitin 2007.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta